



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Kryetarit

Bazuar ne Ligjin per Veteqeverisje Lokale, Nr: 03/L-040, neni 68, Statutit te Komunes Junik te dates 29.9.2010, neni 60. Komuna Junik organizon:

TAKIM PUBLIK ME QYTETARE

Të nderuar bashkëqytetarë,

Ju njoftojmë se të Marten, më datë: 12.06.2024 në orën 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Junikut, do të mbahet takim i hapur me qytetarë, ku të gjithë të interesuarit mund t'i drejtohen kryetarit të komunës për:

- Të arriturat e komunës së Junikut për vitin 2024,
- Infrastruktura komunale (rrugore, ndriçimi, kanalizimi, uji i pijes),
- Shërbimet administrative komunale,
- Planifikimin Urban të Qytetit,
- Buxhetin Komunal,
- Aktivitetet kulturore dhe sportive,
- Prioritetet e komunës për vitin 2024.

Rëndësi të posaçme në këto takime ka pjesëmarrja aktive e qytetarëve me ide dhe sugjerime për avancimin e punëve të institucioneve komunale. Të gjitha shqetësimet, preokupimet dhe sugjerimet tuaja do të jenë të mirëseardhura në këtë takim.

Të nderuar bashkëqytetarë, pjesëmarrja juaj në këtë takim dëshmon përcaktimin tuaj për demokraci, ku si parakusht kryesor nënkupton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu

